



Planuar / Doretuar Primiho/Prodato Received/Delivered	09-03-2023	3	viti god year
Organ./Njësia Organ./Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBHUK	2546/2023		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 576/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr. 1837/2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.Nr.576/2021 të datës 21.06.2021, të parashtruar nga ankuesi _____ nga Lipjani, kundër organit të punësimit Ministria e Financave, në çështjen juridike “kompensim material”, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 si dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 03.03.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. *Aprovohet pjesërisht si e bazuar* ankesa me numër A.nr.552/2019 e datës 17.09.2019, e parashtruar nga ankuesi _____ ashtu që aprovohet pretendimi ankimor lidhur me njohjen e së drejtës së kompensimit të shtesës për angazhimin e ankuesit në Komitetin e Auditimit për periudhën nga data 29.07.2016 deri me datë 28.07.2018, ndërsa, *refuzohet* pretendimi ankimor lidhur me të drejtën e njohjes së kompensimit të shtesës për angazhimin e ankuesit në Komitetin e Auditimit për periudhën nga data 15.07.2015 deri me datë 24.07.2016.

II. *Obligohet* Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr veprimet e nevojshme ligjore për kompensimin e shtesës lidhur me angazhimin e ankuesit në cilësi të kryesuesi të Komitetit të Auditimit për periudhën nga data 29.07.2016 deri me datë 28.07.2019, në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

III. *Anulohet* Vendimi A.nr.271/2018 i datës 06.07.2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Vendimi KZKA 02/2018 i datës 10.04.2018 si dhe Vendimi Nr.08/01/2019 i datës 19.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ministrisë së Financave.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Financave, me datë 17.09.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 4378/2019, e regjistruar nën shenjën A.nr.552/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll 936-1 të datës 19.08.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Financave, me pretendimin ankimor që t'i njihet e drejta e kompensimit në mënyrë retroaktive lidhur me angazhimin e tij në Komitetin e Auditimit në kuadër të Ministrisë së Financave.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje përmes Njoftimit me numër protokoll 5197/2019 të datës 05.11.2019, ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit dhe vendosjes së ankesës numër A.nr.552/2019 të datës 17.09.2019, duke udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.2875/19 të datës 31.05.2021, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në këtë rast ankuesit si dhe ka anuluar njoftimin me numër protokoll 5197/2019 të datës 05.11.2019, duke obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.nr.552/2019 të datës 17.09.2019 të ankuesit

Këshilli në mungesë të anëtarëve, serish me njoftimin me numër protokoll 3814/2021 të datës 21.07.2021 ka informuar ankuesin lidhur me arsyet mos shqyrtimit të ankesës me numër A.nr.552/2019 të datës 17.09.2019, duke udhëzuar të njëjtin lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Ndërsa, Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin A.nr.1837/2021 të datës 27.01.2023 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e datës 21.07.2021 të Këshillit dhe ka udhëzuar të njëjtin që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, të vendos lidhur me ankesën ankuesit ... të datës 17.09.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4378/2019 të datës 17.09.2019,—të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr. 1837/2021 të datës 27.01.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin A.Nr.3222/2021 të datës 21.06.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e datës 05.11.2019 të KPMSHCK; Njoftimin e datës 21.07.2021 të KPMSHCK; Vendimin e datës 15.07.2015 të Komisionit për Emërimin e Komunitetit të Auditimit; Procesverbalin e datës 22.07.2015; Procesverbalin e datës 03.12.2015; Procesverbalin e datës 07.06.2016; Procesverbalin e datës 19.07.2016 të Ankesën e datës 26.07.2019 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ; Vendimin e datës 19.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akt Emërimin e datës 10.12.2015; kërkesën e datës 16.01.2018 për aprovimin e pagesës për angazhimin si Kryesuese i Komunitetit të Auditimit; Vendimin e datës A.Nr.271/2018 të datës Këshillit të Pavarur Mbikëqyrurës për



Shërbimin Civil të Kosovës; Përshkrimin e detyrave të Punës; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 4486 të datës 24.09.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të Aktgjykimit A.nr. 1837/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Financave, tani Ministria e Financave, Punëve dhe Transfereve gjegjësisht sipas Aktit të Emërimit të datës 19.12.2016 ankuesi është i emëruar në pozitën *Udhëheqës i Sektorit për Trajnime dhe Komunikim*. Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se me Vendimin me numër protokoll 1357 të datës 15.07.2015 të Ministrit të Financave ankuesi ishte emëruar Kryesues i Komunitetit të Auditimit, me mandat një (1), vjeçar, ndërsa i njëjti me Vendimin me numër protokoll 1507 të datës 29.07.2016 të Ministrit të Financave, ankuesi serish emërohet Kryesues i Komunitetit të Aditimit, me mandat dy (2) vjeçar.

Ankuesi me datë 16.01.2018 kishte parashtruar kërkesë të Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave lidhur me kompensimin e pagave për kryesuesin e Komitetit të Auditimit siç është përcaktuar me Rregulloren Nr.34/2012 lidhur me Pagesën e Pagave dhe Shtesave të Kryetarëve/Kryesuesve dhe Anëtarëve të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, Komitetit të Auditimit, Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, rrjedhimisht kompensimin nga data e emërimit korrik 2015. Pas heshtjes administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesën e datës 16.01.2018, ankuesi me datë 13.03.2018 kishte parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Financave, i cili me Vendimin KZKA 02/2018 të datës 10.04.2018 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar. Ankuesi me datë 08.05.2018 ushtron ankesë kundër Vendimit KZKA 02/2018 të datës 10.04.2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës Për Shërbimin Civil, kurse ky i fundit me Vendimin A.nr.271/2018 të datës 06.07.2018 ka hedhur poshtë ankesën e ankuesit me arsyetimin e ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor.

Ankuesi serish me datë 26.07.2019, parashtron kërkesë dhe ankesë lidhur me kompensimin e shtesës për angazhim në cilësi të kryesuesit të Komitetit të Auditimit, rrjedhimisht për periudhën nga korriku 2015 deri korrik 2018, ndërsa, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me Vendimin Nr.08/01/2019 të datës 19.08.2019 ka refuzuar ankesën e ankuesit me arsyetimin së i njëjti është dashur të veproj sipas këshillës juridike të dhënë në Vendimin e Këshillit me numër A.nr.271/2018 të datës 06.07.2018.

Ankuesi në ankesën e parashtruar me datë 17.09.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon që t'i njihet e drejta e kompensimit në mënyrë retroaktive lidhur me angazhimin në Komitetin e Auditimit në kuadër të Ministrisë së Financave, sipas Vendimit me numër protokoll 1357 të datës 15.07.2015 dhe Vendimit me numër protokoll 1507 të datës 29.07.2016. Shton së Komiteti i Auditimit është themeluar në mbështetje të nenit 6 të Ligjit Nr.03/L-128 për Auditimin e Brendshëm, ndërsa më Rregulloren Nr.34/2012 për Pagesën e Pagave dhe Shtesave të Kryetarëve/Kryesuesve dhe të Anëtarëve të Bordit për Rishqyrtimin e

Ankesave, Komiteteve të Auditimit, Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, është përcaktuar mënyra e pagesës për kryesuesin dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit.

Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit dhe si rrjedhojë ju referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-128 Për Auditimin e Brendshëm si akt ligjor i zbatueshëm në kohën e emërimit të ankuesit në cilësi të Kryesuesit të Komitetit të Auditimit sipas Vendimit me numër protokolli 1357 të datës 15.07.2015 dhe Vendimit me numër protokolli 1507 të datës 29.07.2016, përkatësisht nenit 6 më të cilin është përcaktuar: *Komiteti i auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës për menaxhmentin e lartë të subjektit të sektorit publik dhe mbështetës për auditorët e brendshëm, duke: 1.1. siguruar një mbikëqyrje të planeve dhe rezultateve të auditimit; 1.2. siguruar pavarësinë e Auditorit të Brendshëm; 1.3. vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit; 1.4. siguruar që rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar; 1.5. këshilluar mbi çështjet lidhur me rreziqet, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditimit.* 2. *Komitetet e Auditimit të Brendshëm krijohen nga menaxhmenti i lartë i subjektit të sektorit publik si në: Kuvendin e Kosovës, Presidencë, Kryeministri, Ministri dhe Komuna. Komitetet e Auditimit të Brendshëm në këto subjekte, kryejnë shërbime për të gjitha njësitë dhe nën njësitë e renditura në kuadër të SSP përkatëse, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me ndonjë akt ligjor. Mënyra e funksionimit të komiteteve të auditimit, rregullohet me Udhëzimet e nxjerra nga Ministri i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa në pajtueshmëri me praktikat dhe standardet ndërkombëtare të auditimit...*

Për më tepër, për vendosje të drejtë Kolegji i Këshillit mori parasysh dispozitat e Rregullores Nr.34/2012 për Pagesën e Pagave dhe Shtesave të Kryetarëve/Kryesuesve dhe të Anëtarëve të Bordit për Rishqyrtimin e Ankesave, Komiteteve të Auditimit, Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, përkatësisht nenin 5 të kësaj Rregullore me të cilin shprehimisht është përcaktuar e drejta në pagesë/shtesë për kryesuesin dhe anëtarët e Komiteteve të Auditimit, rrjedhimisht sipas nenit 5 të Rregullores nr.34/2012 përcaktohet se: *"1. Paga apo shtesa e kryesuesve, dhe anëtarëve të Komiteteve të Auditimit, caktohet si në vazhdim 1.1. Kryesuesi i Komiteteve të Auditimit realizon nga 120 € (euro) për një mbledhje, 1.2 Anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm realizojnë nga 100 € (euro) për një mbledhje. 2. Do të paguhet më së shumti 6 mbledhje brenda një viti.3.Pagesa e kryesuesve dhe anëtarëve të komitetit të auditimit bëhet nga subjekti i sektorit publik që themelohen komitetin"* andaj, mbi këtë bazë ligjore dhe duke nisur nga fakti i pakontestueshëm së ankuesi me vendim të ministrit të Ministrisë së Financave ishte emëruar kryesues i Komitetit të Auditimit në këtë ministri në periudhat kohore të specifikuara si lartë, Kolegji konstaton së ankuesi ka poseduar të drejtën në kompensimin e shtesës lidhur me angazhimin e tij në Komitetin e Auditimit në pajtim me dispozitat e nenit 5 të Rregullores Nr. 34/2012, rrjedhimisht Ministria e Financave si subjekt publik i themelimit të Komitetit të Auditimit ka qenë e obliguar që ankuesit në cilësi të kryesuesit të Komitetit të Auditimit t'i paguaj shtesën e lejuar bazuar në numrin e mbledhjeve të mbajtura. Andaj, bazuar në këto rrethana ligjore dhe faktike, Kolegji konstaton së Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Financave dhe Këshilli gabimisht kanë zbatuar ligjin material me rastin e vendosjes lidhur me çështjen e ankuesit sipas vendimeve të anuluar si në pikën III të dispozitivit të vendimit, sepse, në vlerësimin e Kolegjit ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës me datë 13.03.2018 në KZKA dhe ankesës më datë 08.05.2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ka qenë ende duke ushtruar detyrën e kryesuesit të Auditimit të Brendshëm sipas Vendimit me numër protokolli 1507 të datës 29.07.2016, dhe së e drejta e tij për kompensim material ende nuk ka qenë e përshkruar lidhur me periudhat e përfshira më ankesë.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve për kompensimin në mënyrë retroaktiv në emër të pagesës së pagës/shtesës për angazhim në Komitetin e Auditimit, Kolegji i Këshillit ju referua Ligjit Nr.03/L-212 të Punës përkatësisht nenit 2 paragrafi 1 dhe 2 të ku përcaktohet se: "1.Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës", "2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës", si dhe nenin 87 ku përcaktohet se: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës", andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuar, ngase kërkesa e fundit e ankuesit është parashtruar me datë 26.07.2019, moment nga i cili llogaritet afati i parashkrimit të kërkesës, kështu që e drejta për kompensimin e shtesës për angazhim në Komitetin e Auditimit për periudhën nga data 15.07.2015 deri me datë 24.07.2016 sipas Vendimit me numër protokolli 1357 të datës 15.07.2015 është parashkruar sepse kanë kaluar mbi tri vite, kurse lidhur me kompensimin e kësaj shtese për përudhën nga data 29.07.2016 deri me datë 28.07.2018, Kolegji vendosi si në piken 1 të diapozitivit të këtij vendimi, duke obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, e nw pajtim me dispozita e Rregullores Nr.34/2012 të bëjë kompensimin e shtesës në vlerë prej 120 Euro për çdo mbledhje të mbajtur, lidhur me angazhimine ankuesit në cilësi të anëtarit të Komitetit të Auditimit për periudhën nga data 29.07.2016 deri me datë 28.07.2019.

Theksuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 576/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbaftës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërrkohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë, Financave Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.